



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2811 Prot.

Lezhë, më 3 . 3 . 2022

VENDIM

Nr. 17 Datë 28 . 02 . 2022

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR DY VITET PARA VITIT BUXHETOR, VITIN BUXHETOR 2022 DHE TRE VITET E ARDHSHME BUXHETORE 2023-2025**


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Lezhë, për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2022 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2023-2025, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ



## RAPORT

### Për

### Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave, për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2022 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2023-2025

- A. **Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave**
  - A.1. Detajimi e të ardhurave sipas zërave, pesha tek të ardhurat e Bashkisë,
  - A.2. Te ardhurat nga Taksat
  - A.3. Te ardhurat nga Taksat Vendore
  - A.4. Të ardhurat nga Taksat e Tjera
  - A.5. Te ardhurat Jotatimore
  - A.6. Te ardhurat nga Tarifat Vendore
  - A.7. Te Ardhura nga Qeradhënia e Pronës
  - A.8. Të ardhura të tjera
  - A.9. Të ardhura nga Institucionet Vartëse
- B. **Kapacitetet fiskale të taksapaguesve**
  - B.1. Taksapaguesit familjarë
  - B.2. Taksapaguesit biznese
  - B.3. Taksapaguesit Institucione
- C. **Efekti ekonomik i lehtësirave fiskale,**
- D. **Fluksi Monetar mujor i të ardhurave të veta**
- E. **Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre**

#### A. Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

Në të ardhurat e veta të Bashkisë, hyjnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash Bashkia ka të drejtën t'i përdorë për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është bërë duke u mbështetur në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.157, datë 17.11.2021 "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve", i cili përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nën kategorizimet, këstet e pagesave, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësirave fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve, agjentët tatimor, penaltetet në rastet e moszbatimit të VKB, strukturat përgjegjëse për vendosjen e tyre dhe të drejtat e taksapaguesve për ankimim të çdo njoftim detyrimi/penaliteti në Komisionin Vendor të Apelit, në Bashkinë Lezhë.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë i sipërcituar, përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e zërave të taksave vendore, vendosjen e nivelit të tyre, faturimin, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të qartë dhe të detajuar, në këtë vendim janë të përcaktuara mënyrat e administrimit të saj duke filluar nga kategoritë e taksapaguesve, mënyrën e llogaritjes, strukturat përgjegjëse të faturimit dhe verifikimit të pagesave dhe ato përgjegjëse të mbledhjes së tyre.

Në hartimin dhe deri në marrjen e këtij vendimi nga ana e Këshillit të Bashkisë, ka qenë pjesëmarrës i gjithë komuniteti qytetar dhe ai i biznesit, që ushtron aktivitet në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë, në qytetin e Lezhës, Shëngjinit dhe të gjithë Njësitë e tjera Administrative, të cilët mirëpritën dhe mbështetën iniciativat e titullarit të Bashkisë për zbritjen në nivelin maksimal të të gjithë zërave të taksave vendore, me një ulje prej 30% për taksën e pasurisë dhe politika të tilla me zbritje u ndoqën edhe për përcaktimin e nivelit të taksave të tjera të lejuara, në zbritje të nivelit të tyre siç ishte taksa mbi tabelën dhe të tarifave të tjera vendore.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, ka në përbërje të saj politika nxitëse në vetëdeklarimin e pasurive dhe kryerjen në kohë të pagesave për taksat dhe tarifave vendore, si më poshtë :

- Zbritje e nivelit të taksës mbi pasurinë duke përfshirë taksën mbi ndërtesat për qëllime banimi dhe ato për qëllime biznesi si dhe taksën mbi tokën bujqësore dhe taksën mbi truallin, në maksimumin e mundshëm ligjor prej 30%.
- Zbritje në minimumin e mundshëm ligjor të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, për Njësitë Administrative.
- Përfshirje nga pagesa e tarifave për shërbimet publike, si pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, dekori dhe mirëmbajtja e varrezave publike, për të gjithë kryefamiljarët invalid, ato që kanë në përbërje të tyre të verbërit, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ato që janë përfitues të ndihmës ekonomike, pensionistët e vetëm ose me persona madhorë të papunë ose persona invalid, gratë e dhunuara, gratë kryefamiljare me fëmijë deri të moshës 18 vjeç dhe ose deri në përfundim të studimeve të larta, familje të varfra me nivel ekonomik të ulët dhe nënat beqare.

Gjatë vitit të kaluar ne arritëm të ndërtojmë një regjistër me të dhënat për taksapaguesit familjarë, në të gjithë territorin e Bashkisë, duke ndërtuar bazat e të dhënave të sakta, të cilat do azhurnohen për çdo periudhë, që ato do faturohen nga DTTV, Njësitë Administrative dhe Agjenti Tatimor SHAUK, Lezhë.

Peshën kryesore në këtë kategori taksapaguesish e mbajnë Njësitë Administrative dhe Agjenti Tatimor (Sh.A. Ujësjellës Kanalizime, Lezhë), të cilët kanë tagrin dhe detyrimin e mbajtjes së regjistrit të saktë të kategorisë së taksapaguesve "Familjar", faturimin e tyre për taksën mbi pasurinë dhe tarifave të shërbimeve publike, që ato përfitojnë. Planifikimi i të ardhurave për këto zëra për këtë kategori taksapaguesish është bërë bazuar në këtë regjistër. Në fillimin e vitit 2022, ne kemi filluar bashkëpunimin edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave, për


të filluar me aksesin në ASHK (Agjencinë Shtetërore të Kadastrës) me qëllim lidhjen e të dhënave për pasuritë e palucjteshme.

Në planifikimin e të ardhurave totale të Bashkisë, kanë marrë pjesë të gjithë Drejtoritë kryesore, Njësitë Administrative dhe Agjenti Tatimor, të cilët kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e parashikimit, faturimit dhe vjeljes së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për çdo kategori taksapaguesi dhe raportimin mujor për ecurinë e vjeljes së tyre. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e mëtejshëm të shërbimeve, që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, që janë taksat vendore dhe taksa të tjera, të ardhurat jotatimore, që janë nga tarifatat vendore dhe të ardhurat nga burime të tjera.

Nr	Emërtimi	Fakti		Plani	P.B.A.		
		2020	2021	2022	2023	2024	2025
1.	Të Ardhura nga Taksat	179.858	304.922	462.891	481.040	503.754	520.246
1.1	Të Ardhura nga Taksat Vendore	129.529	254.043	419.391	436.490	457.654	472.596
1.2	Të Ardhura nga Taksat e Tjera	50.329	50.879	43.500	44.550	46.100	47.650
2.	Të Ardhura Jotatimore	156.744	229.010	277.109	296.228	310.837	300.016
2.1	Të Ardhura nga Tarifatat Vendore	118.412	163.951	198.666	214.678	227.992	235.113
2.2	Të Ardh. Qeradhënia e Pronës	7.798	8.828	8.385	7.185	7.185	6.943
2.3	Të Ardhura të Tjera	25.257	48.520	56.890	60.405	61.700	44.000
2.4	Të Ardhura nga Institucionet Vartëse	5.277	7.711	13.168	13.960	13.960	13.960
<b>Të Ardhura Gjithsej</b>		<b>336.602</b>	<b>533.932</b>	<b>740.000</b>	<b>777.268</b>	<b>814.591</b>	<b>820.262</b>

Ecuaria e realizimit dhe planifikimit në totalin e të ardhurave, ndër vite dhe PBA 2023-2025



#### A.1. Detajimi e të ardhurave sipas zërave, pesha tek totali i të ardhurave të Bashkisë.


Referuar bazës ligjore të funksionimit të qeverisjes vendore, Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj si dhe mbledhjen dhe administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuar në ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet kryesisht në:

1. Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920, datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhënr.157, datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve” si dhe në të gjithë udhëzimet dhe VKM në zbatim të legjislacionit të sipërcituar.

Pesha, që zënë taksat e tarifat vendore dhe të ardhura të tjera, të planifikuara nga të gjithë Dretoritë, Njësitë Administrative dhe Agjenti Tatimor, për vitin buxhetor 2022, në raport me totalin e të ardhurave për taksat, tarifat dhe totalin e të ardhurave, ka paraqitjen grafike si më poshtë :



- Taksat vendore 57%
- Taksa nga Institucionet e treta 6%
- Tarifat vendore 27%
- Nga dhënia me qera 1%
- Të ardhura të tjera 7%
- Nga Institucionet e treta vartëse 2%

Në raport me realizimin e një viti më parë ne kemi një rritje të planifikimit të të ardhurave, që vijnë nga taksat dhe tarifat vendore me një shifër prej 38.6%.


Peshën kryesore në këtë rritje kaq të lartë e ka taksa e Ndikimi në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, e cila në vitin e kaluar 2021 u realizua në masën e 133.200 mijë lekë, ndërsa për vitin buxhetor 2022 është planifikuar në masën e 298.780 mijë lekë ose rreth 2.5 herë më shumë se realizimi i një viti më parë, ndërkohë, që në totalin e të ardhurave, ky zë takse, zë një peshë specifike mjaft të lartë prej 40% të të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë.

Pesha, që zënë taksat e tarifat vendore, të planifikuara nga Njësitë Administrative dhe Agjenti tatimor, vetëm për kategorinë e taksapaguesve “Familjar”, për vitin buxhetor 2022, në raport me totalin e të ardhurave për taksat, tarifat dhe totalin e të ardhurave (000 / lekë), kap vlerën e 75.721 mijë lekë ku Taksa mbi Ndërtesat dhe tarifa e Shërbimeve publike kapin vlerën më të lartë dhe më pas vijnë taksa mbi truallin dhe Taksa mbi Tokën Bujqësore. Ajo paraqitet me treguesit e planifikimit dhe grafikun si më poshtë :


Nr	Njësitë Administrative.	T.Ndërtese	T.Trualli	T.T.Bujq.	T.Sh.Publ.	Totali
1	Balldre	339	18	994	31	1.442

2	Blinisht	119	35	588	70	812
3	Dajç	118	10	448	112	688
4	Kallmet	191	22	522	67	802
5	Kolsh	360	36	720	360	1.476
6	Lezhë	805	0	0	1.375	2.180
7	Shëngjin	405	35	577	509	1.526
8	Shënkoll	3.167	198	3.862	2.970	10.197
9	Ungrej	106	13	55	0	174
10	Zejmen	1.190	117	2.627	589	4.523
11	A.Tat. Sha.U.K. Lezhe	25.262	0	0	26.640	51.902
Totali		32.122	484	10.393	32.722	75.721

Peshën kryesore në të ardhurat, që vijnë si rezultat i faturimit dhe arkëtimit për taksat dhe tarifat vendore, për kategorinë Familjar, e mban Agjenti tatimor, Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, ku nga 75.721 mijë lekë të planifikuara në total, janë planifikuar të ardhura në shumën e 51.902 mijë lekë ose 68,5% të planit, nga të cilat 33.3% nga Taksat mbi Ndërtesat dhe diferenca prej 35.2% nga Tarifat e Shërbimeve Publike.




Shpërndarja spas Njësiye Administrative dhe Agjentit Tatimor Sh.A. UK, Lezhë



Njësitë Administrative, përfshirë këtu edhe Njësinë Qendër, në raport me totalin e të ardhurave të planifikuara për vitin 2022, zërat e taksave dhe tarifave kanë këtë peshë në përqindje si më poshtë :

Nr	Emertimet e zërave	Plani në total	Njësitë Adm.	Pasha në përqindje
1	Taksat Vendore	419.391	17.737	4.2%
2	Tarifat Vendore	198.666	6.082	3.1%
Totali		740.000	23.819	3.2%

Në totalin e taksave vendore Njësitë Administrative zënë 4.2% të të ardhurave nga taksat, ndërsa në totalin e tarifave vendore 3.1%, duke kapur një vlerë në total prej 23.819 mijë lekë ose 3.2% e totalit të të ardhurave të Bashkisë nga taksat dhe tarifat vendore.



Agjenti Tatimor, Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime, në raport me totalin e të ardhurave të planifikuara për vitin 2022, zërat e taksave dhe tarifave kanë këtë peshë në përqindje si më poshtë :

Nr	Emertimet e zërave	Plani në total	Agjenti Tatimor Sh.A. UK	Pasha në përqindje
1	Taksat Vendore	419.391	25.262	6%
2	Tarifat Vendore	198.666	26.640	13.4%
Totali		740.000	51.902	7%

Në totalin e taksave vendore Agjenti Tatimor, Sh.A. Ujësjetllës Kanalizim zë 6% të të ardhurave nga taksat, ndërsa në totalin e tarifave vendore 13.4%, duke kapur një vlerë në total prej 51.902 mijë lekë ose 7% e totalit të të ardhurave të Bashkisë nga taksat dhe tarifat vendore.




Tabela e të ardhurave nga zërat e taksave vendore, duke i detajuar ato sipas zërave të tyre, nga zërat e tarifave vendore, sipas llojit të shërbimeve publike dhe ato administrative, të cilat planifikohen, faturohen dhe arkëtohen nga Bashkia Lezhë dhe nga Institucionet e treta, që shërbejnë si agjent tatimor, të ardhurat nga përdorimi i pasurive dhe dhënia me qera e tyre, të ardhura nga burime të tjera nga Institucionet vartëse, për dy vitet para vitit buxhetor 2020-2021, vitin buxhetor 2022 dhe tre vitet e ardhshme të PBA (Projektit Buxhetor Afatmesëm) 2023-2025, paraqitet me të dhënat si më poshtë :













12.1	12.2	12.3	12.4	12.5	12.6	12.7	12.8	12.9	12.10	12.11	12.12	12.13	12.14	12.15	12.16	12.17	12.18	12.19	12.20	12.21	12.22	12.23	12.24	12.25	12.26	12.27	12.28	12.29	12.30	12.31	12.32	12.33	12.34	12.35	12.36	12.37	12.38	12.39	12.40	12.41	12.42	12.43	12.44	12.45	12.46	12.47	12.48	12.49	12.50	12.51	12.52	12.53	12.54	12.55	12.56	12.57	12.58	12.59	12.60	12.61	12.62	12.63	12.64	12.65	12.66	12.67	12.68	12.69	12.70	12.71	12.72	12.73	12.74	12.75	12.76	12.77	12.78	12.79	12.80	12.81	12.82	12.83	12.84	12.85	12.86	12.87	12.88	12.89	12.90	12.91	12.92	12.93	12.94	12.95	12.96	12.97	12.98	12.99	13.00
12.1	12.2	12.3	12.4	12.5	12.6	12.7	12.8	12.9	12.10	12.11	12.12	12.13	12.14	12.15	12.16	12.17	12.18	12.19	12.20	12.21	12.22	12.23	12.24	12.25	12.26	12.27	12.28	12.29	12.30	12.31	12.32	12.33	12.34	12.35	12.36	12.37	12.38	12.39	12.40	12.41	12.42	12.43	12.44	12.45	12.46	12.47	12.48	12.49	12.50	12.51	12.52	12.53	12.54	12.55	12.56	12.57	12.58	12.59	12.60	12.61	12.62	12.63	12.64	12.65	12.66	12.67	12.68	12.69	12.70	12.71	12.72	12.73	12.74	12.75	12.76	12.77	12.78	12.79	12.80	12.81	12.82	12.83	12.84	12.85	12.86	12.87	12.88	12.89	12.90	12.91	12.92	12.93	12.94	12.95	12.96	12.97	12.98	12.99	13.00
12.1	12.2	12.3	12.4	12.5	12.6	12.7	12.8	12.9	12.10	12.11	12.12	12.13	12.14	12.15	12.16	12.17	12.18	12.19	12.20	12.21	12.22	12.23	12.24	12.25	12.26	12.27	12.28	12.29	12.30	12.31	12.32	12.33	12.34	12.35	12.36	12.37	12.38	12.39	12.40	12.41	12.42	12.43	12.44	12.45	12.46	12.47	12.48	12.49	12.50	12.51	12.52	12.53	12.54	12.55	12.56	12.57	12.58	12.59	12.60	12.61	12.62	12.63	12.64	12.65	12.66	12.67	12.68	12.69	12.70	12.71	12.72	12.73	12.74	12.75	12.76	12.77	12.78	12.79	12.80	12.81	12.82	12.83	12.84	12.85	12.86	12.87	12.88	12.89	12.90	12.91	12.92	12.93	12.94	12.95	12.96	12.97	12.98	12.99	13.00

## **A.2. Të Ardhurat nga Taksat**

Në të ardhurat tatimore (nga taksat) hyjnë të gjithë të ardhurat, që vijnë si rezultat i aplikimit të Taksave Vendore, të cilat vilen nga Bashkia, dhe të Taksave të Tjera, të cilat vilen nga Institucione të treta Shtetërore, që shërbejnë si agjent tatimor për vjeljen e këtyre të ardhurave dhe mbajnë përqindjen e tyre në raport me totalin e të ardhurave të arkëtuara.

## **A.3. Të Ardhurat nga Taksat Vendore**

Në Taksat Vendore futen të gjithë ato zëra, që janë të përcaktuara qartë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe janë si më poshtë :

### **A.3.1. Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtëshme**

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- A.3.1.1. Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat për qëllime banimi dhe për qëllime biznesi)
- A.3.1.2. Taksa mbi tokën bujqësore.
- A.3.1.3 Taksa mbi truallin.

Parashikimi për vitin buxhetor 2022 dhe për tre vitet e ardhshme buxhetore 2023-2025 bazohet kryesisht tek zgjerimi në maksimum i bazës së taksapaguesve dhe përafrimit drejt realitetit të të dhënave mbi pasuritë e taksapaguesve, nëpërmjet:


- ✓ Evidentimit të plotë të gjithë taksapaguesve, që nuk kanë kryer deklarimin ligjor për pasuritë, që ato disponojnë dhe njoftimin ndaj tyre për të sjellë dokumentacionin përkatës ligjor.
- ✓ Saktësimin e sipërfaqeve të taksueshme nëpërmjet matjeve, që do kryehen nga Komisioni i Verifikimit të Pasurive, i ngritur me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, në zbatim të detyrave të miratuara sipas VKB përkatëse.
- ✓ Mbështetja në mbledhjen e të ardhurave dhe shkëmbimin e informacionit, që do kemi në këto raste nga agjenti tatimor, Sh.A.U.K. Lezhë.
- ✓ Këstimin të pagesave për kategorinë e taksapaguesve familjarë.
- ✓ Ofrimin të shërbimit të zyrës me një ndalesë për çdo Njësi Administrative, duke lehtësuar burokracinë në këtë drejtim.
- ✓ Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucione si Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ZRRPP, ALUIZNI etj.

Në parashikimin e vlerës, që ne mendojmë të arkëtojmë gjatë vitit buxhetor 2022, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për ato zëra të taksave, që ajo ka tagrin dhe detyrimin t'i planifikojë, faturojë, vjelë, arkëtojë dhe të raportojë për ecurinë e tyre, është bazuar kryesisht në të dhënat, që disponon për numrin e subjekteve, që janë të regjistruar në QKB si dhe në të dhënat, që ndodhen në dosjen e çdo taksapaguesi, me qëllim përafrimin e planit me kapacitetin fiskal të taksapaguesve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë, por edhe mbi parashikimet për rritjen e numrit të bizneseve gjatë kësaj periudhe.

Sa i përket kategorisë së taksapaguesve familjarë, të dhënat akoma nuk janë në nivelin e duhur, por ne gjykojmë se janë drejt përmirësimit, lidhur me listimin e të gjithë kryefamiljarëve të Bashkisë Lezhë si në qytetin e Lezhës ashtu edhe nëpër të gjithë Njësitë Administrative për të dhënat mbi sipërfaqet e banesave, që ato kanë në pronësi. Por, parashikimi i këtyre të ardhurave për kategorinë “familjar”, është bazuar kryesisht në mënyrën e mbledhjes së këtyre të ardhurave konform legjislacionit në fuqi, kur mungojnë të dhënat, që për Taksën mbi Ndërtesat merret një sipërfaqe prej 70 - 100 m<sup>2</sup> për çdo kryefamiljar, referuar ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe VKM nr.132, datë 07.03.2018, neni 2, pika 2.1, sipërfaqja e prezumuar.

Për vitin buxhetor 2022, të ardhurat e parashikuara nga Taksa mbi Pasurinë kap vlerën e 105.116 mijë lekë ose 25% e të ardhurave nga taksat vendore ose 14% e të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë, ndërsa pasha specifike e të ardhurave nga zërat e taksës mbi pasurinë, renditen si më poshtë :

- ✓ Taksa mbi ndërtesat kap vlerën e 79.122 mijë lekë ose 75.3% e taksës mbi pasurinë ose 18.9% e taksave vendore ose 10.7% e të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë.
- ✓ Taksa mbi Tokën Bujqësore, kap vlerën e 10.410 mijë lekë ose 9.9% e taksës mbi pasurinë ose 2.5% e taksave vendore ose 1.4% e të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë.
- ✓ Taksa mbi Truallin, kap vlerën e 15.584 mijë lekë ose 14.8% e taksës mbi pasurinë ose 3.7% e taksave vendore ose 2.1% e të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë.




#### A.3.2. Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Sipas ligjit 142/2015, datë 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30.08.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 11, Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të Bashkisë Lezhë.

Ndryshimet e fundit ligjore në uljen në nivelin zero, të Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për subjektet me xhiro nga 0-14 milion lekë, çoi në planifikimin zero të të ardhurave nga ky zë i taksave vendore, pamvarësisht arkëtimeve, që mund të ketë gjatë këtij viti nga detyrimet e prapambetura të palikujduara nga ajo kategori biznesesh, por që nuk mund të parashikohen në buxhet.

### A.3.3. Të ardhura nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

Planifikimi i të ardhurave nga zëri Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve të bëra nga kategoritë e biznesit dhe qytetarëve përndërtime të reja si dhe në shlyerjen e detyrimeve për objektet, të cilat janë në proces legalizimi.



Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, për vitin buxhetor 2022 është planifikuar në masën e 298.780 mijë lekë. Pesha specifike, që zë në totalin e të ardhurave, ky zë i taksës, kap vlerën e 40% të të ardhurave totale të Bashkisë Lezhë, prej 740.000 mijë lekë, ndërsa në raport me totalin e zërit të taksave vendore, të planifikuara në vlerën e 419.931 mijë lekë, pesha specifike në përqindje kap vlerën e 71.2%.

### A.3.4. Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Në planifikimin e këtij zëri të taksës jemi mbështetur kryesisht në të dhënat e marra nga çdo dokumentacion fizik në dosjen e çdo taksapaguei, në akt-konstatimet e mbajtura nga specialistët e Sektorit të Kontrollit dhe Verifikimit në Terren si dhe tek deklaratimet e bëra nga vetë subjektet.

Gjithashtu një tregues tjetër ka qenë edhe fakti / realizimi i këtij zëri të taksës në vitin e kaluar buxhetor 2021. Arsyet e rënies së nivelit të realizimit të këtij zëri për vitin e shkuar 2021 dhe në planifikimin në vitin buxhetor 2022 dhe në tre vitet e ardhshme buxhetore 2023-2025, është kryesisht zbritja e nivelit të taksës me vendimin përkatës të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Megjithatë do vazhdojë më të njëtin ritëm mirë menaxhimi i procesit të kontrollit dhe verifikimit në terren, pasi një pjesë e madhe e sipërfaqeve të tabelave me dimensione të mëdha nuk janë faturuar fare ose janë konsideruar jo si pjesë përbërëse e zbatimit të ligjit për taksën e tabelës.

Janë të shumta rastet e konsiderimit të tabelës, që përdoret për qëllime reklamimi si tabelë identifikuese, duke çuar kështu në uljen e nivelit të taksës në kundërshtim me ligjin dhe paralelisht konsiderohet edhe si një ndotje vizuale duke vendosur tabela nëpër rrugët e qytetit.

### A.3.5. Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Me "Hotel" kuptohet çdo subjekt tregtar, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritëjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret

për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Detyrimi për taksën i takon klientit, që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogaritë bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhembti të vlera e taksës.

Shtimi i numrit të kontrolleve dhe verifikimeve në terren nga strukturat e sektorit të kontrollit por edhe nga strukturat e Policisë Bashkiake do ndikojë pozitivisht dhe do jetë një nga faktorët kryesorë në rritjen e të ardhurave nga ky zë krahasuar me një vit më parë.

#### **A.3.6. Të ardhurat nga Taksat e Përkohshme**

Në këtë zë të ardhurash nuk janë të përfshira detyrimet e prapambetura nga subjektet, të cilat nuk i kanë shlyer në kohë detyrimet për ato zëra të taksave të përkohshme, që kanë qenë në fuqi sipas VKB të viteve të mëparshme, pasi referuar bazës ligjore debitë mbi 18 muaj nuk mund të jenë pjesë e planit të të ardhurave. Bashkia Lezhë nuk ka miratuar asnjë zë takse të përkohshme, për asnjë kategori taksapaguesi.

#### **A.4. Të Ardhura nga Taksa të Tjera**

Të ardhurat nga Taksat e Tjera bazohen në Ligjin numër 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 25, ku Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet Kombëtare, që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare, që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës, ku Institucionet përkatëse mbajnë përqindjet konform legjislacionit në fuqi si agjent tatimor.

**A.4.1. Të ardhurat nga Taksa e Kalimit të së Drejtës së Pronësisë për Pasurinë e Paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;** Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. Planifikimi bëhet bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara dhe rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga agjenti tatimor.

#### **A.4.2. Të ardhurat nga Taksa Vjetore për Qarkullimin e Mjeteve të Përdorura;**

Bazuar në Ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë. Referuar pikës 3, të Nenit 4, të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 25% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkisë.



**A.4.3. Të ardhurat nga Renta Minerare,** sipas përcaktimeve në ligjin për taksat kombëtare; Bazuar në nenin 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, baza e Taksës së Rentës Minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin.

Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Degët e doganave në rrethë ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin eshitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë në llogarinë e Degës së Thesarit. Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.

## A.2. Trendi i të ardhurave nga Taksat

Në zërat e taksave hyjnë të ardhurat nga taksat vendore dhe të ardhurat nga taksat, të cilat vilen nga Institucionet e treta, që shërbejnë si agjent tatimor. Në total të ardhurat nga taksat për vitin e shkuar 2021 u realizuan në masën e 304.922 mijë lekë nga 518.074 mijë lekë të planifikuara ose 58.9% e planit. Në mosrealizimin e këtij zëri të taksave, ndikimin më të madh e kanë zërat e taksave vendore, që mbledhen nga Bashkia pasi të ardhurat e arkëtuara nga Institucionet e treta, janë me tregues mbi planin e të ardhurave, duke kapur vlerën e 50.879 mijë lekë nga 39.150 mijë lekë të planifikuara ose 30% mbi planin.

## A.3. Trendi i të ardhurave nga Taksat Vendore

Gjatë vitit 2021, kemi një mosrealizim të ndjeshëm të të ardhurave nga zëri i taksave vendore, ku nga 478.924 mijë lekë të planifikuara u realizuan të ardhura në masën e 254.043 mijë lekë ose 53% e planit të të ardhurave.


Ndikimin negativ në këtë mosrealizim të planit e kanë dhënë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, e cila është realizuar në masën e 133.200 mijë lekë nga 358.909 mijë lekë të planifikuara ose 37% e planit.

Nëse kjo diferencë do ishte arkëtuar atëherë realizimi i planit të të ardhurave për zërin e taksave vendore, do e tejkalonte planin, pasi kemi një realizim shumë të kënaqshëm për zërat e tjerë të taksave vendore, si taksa mbi pasurinë, taksa mbi tabelën dhe taksa e fjetjes në hotele. Arsyet e mosrealizimit të zërit të taksës së ndikimit në infrastruktura janë nga rënia e numrit të lejeve në fushën e ndërtimit, për shkak të ndëprejës së investimeve në fushën e ndërtimit.

Nr	Emertimi	Fakt		Plan 2022	P. B. A.		
		2020	2021		2023	2024	2025
<b>i</b>	Taksa mbi Pasurine	71.804	99.624	105.116	116.490	122.154	124.396
<b>a</b>	Taksa mbi Ndërtesat	54.526	78.674	79.122	83.739	86.182	87.631
<b>b</b>	Taksa mbi T. Bujqësore	4.577	5.105	10.410	15.007	17.585	17.879
<b>c</b>	Taksa mbi Truallin	12.701	15.845	15.584	17.744	18.387	18.886


2	Tat. Th.Fitimin	8.869	6.025	300	0	0	0
3	T.Ndik. Infrastr. Ndërtimet e Reja	31.270	133.200	298.780	300.000	310.000	320.000
4	Taksa mbi Tabelën	11.616	5.114	4.750	5.000	5.500	5.700
5	Taksa Fjetjes Ne Hotele	4.409	9.663	10.445	15.000	20.000	22.500
6	Taksa të Përkohshme	1.561	417	0	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>129.529</b>	<b>254.043</b>	<b>419.391</b>	<b>436.490</b>	<b>457.654</b>	<b>472.596</b>

### Ecuaria e realizimit dhe planifikimit të Taksave Vendore, nder vite dhe PBA 2023-2025



Peshën specifike në përqindje, në realizimin e të ardhurave të çdo zëri takse e tarife, për vitin e kaluar 2021, më të madhe në raport me totalin e të ardhurave, që vijnë nga taksat vendore, e zuri Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, që kap vlerën e 133.200 mijë lekë ose rreth 52% e totalit të të ardhurave nga Taksat Vendore, i cili ishte në vlerën e 254.043 mijë lekë.


Në vendin e dytë pastaj renditet Taksa mbi Ndërtesat, e cila kapi vlerën e 78.674 mijë lekë ose 31% e totalit të të ardhurave nga Taksat Vendore, në vendin e tretë renditet Taksa mbi Truallin, e cila kap vlerën e 15.845 mijë lekë ose 6% e totalit të të ardhurave nga taksat vendore, ndërsa në vendin e katërt renditet Taksa e Fjetjes në Hotele, e cila kapi vlerën e 9.663 mijë lekë ose 4% e totalit të të ardhurave nga taksat vendore dhe diferencë ngelet tek Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin, Taksa mbi Tokën Bujqësore, Taksa mbi Tabelat dhe nga Taksat e Përkohshme për detyrime të palikujduara, të cilat kanë sjellë të ardhura gjithsej në masën e 16.661 mijë lekë ose 6.6% e totalit të të ardhurave nga Taksat Vendore.




Në total plani i të ardhurave nga zëri i taksave vendore, nga 478.924 mijë lekë të planifikuara u realizua në masën e 254.043 mijë lekë, me një vlerë prej 224.881 mijë lekë më pak ose 53% e planit.

Për këtë vit buxhetor 2022, në planin e të ardhurave nga taksat vendore, vendin e parë për nga shuma e të ardhurave të planifikuara, e zë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, e cila kap vlerën e planifikuar në masën e 298.780 mijë lekë ose 71.2% të totalit të të ardhurave nga taksat vendore.

Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëri i Taksës Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, paraqitet si më poshtë :



Arsyet e rritjes së planifikimit të këtij zëri taksë për këtë vit buxhetor 2022, është informacioni, që ne kemi për projektet e mëdha në fushën e infrastrukturës dhe rritja e nivelit të investimeve në fushën e turizmit. Ndërsa në zërat e tjerë të të ardhurave nga taksat vendore, rritja është në përqindje jo kaq të lartë në raport me realizimin e një viti më pare, për çdo zë taksë.




Në vendin e dytë, në planifikimin e të ardhurave nga taksat vendore për vitin buxhetor 2022, renditet Taksa mbi Pasurinë, e cila kap vlerën e 105.116 mijë lekë ose 25% e totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Krahasuar me vitet e shkuara, ky zë taksë ka një rritje mjaft të ndjeshme dhe me tregues mjaft pozitiv, pasi rritja ka ecur vit pas viti, jo vetëm me planifikimin e këtij zëri por paralelisht edhe me realizimin e tij, përjashto vitin e pandemisë 2020.

Në vitin që kaluam, kemi një realizim të zërit të taksës mbi pasurinë në vlerën e 99.623 mijë lekë nga 95.515 mijë lekë të planifikuara ose me një tejkalim prej 4.3% më shumë se plani ose 27.819 mijë lekë më shumë se viti mëparshëm 2020.

Nr	Emërtimi	Fakt			Plani 2022	P.B.A.		
		2019	2020	2021		2023	2024	2025
1	Taksa mbi pasurinë	66.184	71.804	99.623	105.116	116.490	122.154	124.396

Paraqitja grafike e të ardhurave nga Taksa mbi Pasurinë dhe Planifikimi për PBA 2023-2025




Brenda këtij zëri, peshën specifike më të madhe e ka Taksa mbi Ndërtesat, e cila është planifikuar në masën e 79.122 mijë lekë ose 75.3% e totalit të Taksës mbi Pasurinë.

Në zërin e Taksës mbi Ndërtesat, peshën specifike më të madhe e ka Taksa mbi Ndërtesat për kategorinë Biznes, e cila kap vlerën e 47.000 mijë lekë ose 59.4% të totalit të taksës mbi ndërtesat, ndërsa diferenca brenda këtij zëri i përket kategorisë së taksapaguesve "Familjar", që mbliidhen nga Agjenti Tatimor Sh.A.U.K. Lezhë, e planifikuar në masën e 25.262 mijë lekë ose 31.9% të totalit të taksës mbi ndërtesat dhe nga Njësitë Administrative në masën e 6.860 mijë lekë ose 8.7% të totalit të taksës mbi ndërtesat.


Pjesë e zërave të Taksës mbi Pasurinë janë edhe Taksa mbi Truallin dhe Taksa mbi Tokën Bujqësore, të cilat respektivisht janë planifikuar për vitin 2022 në vlerën 15.584 mijë lekë ose 14.8% e zërit të Taksës mbi Pasurinë dhe 10.410 mijë lekë ose 9.9 % e zërit të Taksës mbi Pasurinë.

Parashikimet e vitit korent buxhetor 2022 për zërin e Taksës mbi pasurine, krahasuar me vitin e kaluar 2021 janë me ritme mjaft të larta, duke kapur vlerën e 105.116 mijë lekë nga 99.624 mijë lekë të realizuara një vit më parë, me një rritje prej 5.5% të të ardhurave nga ky zë i taksave vendore, ndërsa parashikimet afatmesme për periudhen 2023-2025 janë planifikuar me një rritje të dyfishuar për vitin e parë të PBA 2023 dhe dy vitet e tjera me të njëjtin ritëm si viti 2022.


Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëri i Taksës mbi Ndërtesat paraqitet si më poshtë :



Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëti i Taksës mbi Tokën Bujqësore, paraqitet si më poshtë :




Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëri i Taksës mbi Truallin, paraqitet si më poshtë :



Më pas në vendin e tretë renditet Taksa e Fjetjes në Hotele, e cila është planifikuar në masën e 10.445 mijë lekë ose 2.5% e të ardhurave nga Taksat Vendore. Për vitin, që lamë pas, ky zë takse është realizuar në masën e 9.663 mijë lekë nga 10.000 mijë lekë të planifikuara, me një realizim mjaft pozitiv të treguesve të planit me rreth 97%, ndërsa për vitin 2022 ne kemi parashikuar një rritje prej rreth 4.5% të planit, duke vendosur vlerën e 10.445 mijë lekë për zërin e Taksës së Fjetjes në Hotele, bazuar kryesisht në ndryshimet e fundit në paketën fiskale mbi rritjen e penaliteteve në rastet e mosdeklarimit të saktë të numrit të fjetjeve dhe plotesimit të regjistrimit të fjetjes sipas standarteve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë Lezhë, por edhe në rritjen e numrit të pushuesve kryesisht gjatë sezonit turistik.


Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëri i Taksës së Fjetjes në Hotele, paraqitet si më poshtë :



Parashikimet afatmesme për periudhën 2023-2025 janë planifikuar me një rritje mesatare prej 5%, vit pas viti, shifër e cila kap rritjen prej 13% në vitin e fundit të PBA, i gjithë ky arsyetim bazohet në rritjen e numrit të frekuentuesve dhe pushuesve gjatë sezonit turistik.

Në vendin e katërt, tek zëri i taksave vendore renditet Taksa e Tabelës, e cila është planifikuar në masën e 4.750 mijë lekë, nga 5.114 mijë lekë të realizuara gjatë vitit 2021. Arsyet e planifikimit me zbritje në këtë zë takse, më kryesori është se shumë nga të ardhurat e vjelura gjatë vitit të kaluar për këtë zë takse, ishin nga detyrimet e prapambetura të faturuara gjatë vitit 2020 si dhe ndryshimet e fundit, që ne bëjmë tek niveli i këtij zëri të taksave vendore, duke zbritur në një nivel thuajse dysheme krahasuar me nivelin e aplikuar gjatë vitit 2020.

Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga zëri i Taksës së Tabelës, paraqitet si më poshtë :




Ndërsa në fund fare, vijnë të ardhurat e planifikuara nga zëri i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, planifikuar në një nivel shumë të ulët prej 300 mijë lekë, referuar ndryshimeve ligjore të fundit, përsa i përket kategorive, që i nënshtrohen pagesave të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Këto të ardhura të planifikuara janë vendosur duke pritur vetëm të ardhurat e pa paguara nga ajo kategori biznesi.

#### A.4. Trendi i të Ardhurave nga Taksat e Tjera

Nr	Emertimi	Fakt		Plan 2022	P . B . A .		
		2020	2021		2023	2024	2025
1	Taksa e Kal. Drej. Pron. Pas. Paluej.	7.705	9.986	8.500	9.000	9.500	10.000
2	Taksa e Mjeteve te Perdorura	41.573	40.334	34.500	35.000	36.000	37.000
3	Taksa mbi Renten Minerale	251	508	500	550	600	650
4	Të Tjera	800	51	0	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>50.329</b>	<b>50.879</b>	<b>43.500</b>	<b>44.550</b>	<b>46.100</b>	<b>47.650</b>

Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga Taksat, që vilen nga Institucionet e Treta, kapi realizimin për vitin 2021 në vlerën prej 50.879 mijë lekë ose pothuajse me të njëjtin nivel si një vit më parë, ndërsa treguesit e ecurisë ndër vite dhe të planifikimit për PBA 2023-2025, paraqiten si më poshtë:



Për vitin e kaluar buxhetor 2021 peshën më të madhe në zërat e Taksave të Tjera e zë Taksa e Mjeteve të Përdorura, e cila kap vlerën e 40.334 mijë lekë ose 79.3% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera, më pas vjen e Taksa e Kalimit të së Drejtës së Pronësisë, e cila ka kapur vlerën e 9.986 mijë lekë ose 19.6% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera, kurse vendin e tretë renditet Taksa mbi Rentën Mirerare, e cila ka kapur vlerën e realizimit në shumën e 508 mijë lekë ose 1% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera dhe zëri i taksave të tjera, që kap vlerën e 51 mijë lekë ose 0.1 % e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera.

Duke i konsideruar si taksa, që nuk menaxhohen nga pushteti Vendor, pasi ato vilen me agjentë tatimor, të cilët marrin përqindjen e caktuar konform ligjit në raport me arkëtimet, që ato bejnë për këto zëra taksash, për vitin buxhetor 2022 ato janë planifikuar bazuar kryesisht në nivelet e arkëtimeve të një viti më parë.

Kështu në vendin e pare, për vitin buxhetor 2022, renditet po e njëjta taksë e cila është Taksa e e Mjeteve të Përdorura, e cila është planifikuar në vlerën e 34.500 mijë lekë ose rreth 80% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera. Më pas vjen e Taksa e Kalimit të së Drejtës së Pronësisë, e cila është planifikuar në vlerën e 8.500 mijë lekë ose rreth 20% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera, kurse vendin e tretë renditet Taksa mbi Rentën Mirerare, e cila është planifikuar në vlerën e 500 mijë lekë ose rreth 1% e totalit të të ardhurave nga Taksat e Tjera.

#### A.5. Të Ardhurat Jotatimore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifave vendore për shërbimet publike, që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj.

Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj. Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikën dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.


Për vitin buxhetor 2022, të ardhurat jotatimore të parashikuara kapin vlerën e 277.109 mijë lekë ose 37% të të ardhurave totale. Peshën më të madhe në kategorinë të ardhurave jotatimore e zënë të ardhurat nga tarifave vendore, ku përqindjen më të madhe e kap zëri i tarifës për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi e largimi i mbetjeve, gjelbërimi, ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e varrezave publike, ndërsa më pas vijnë tarifave të tjera, të cilat i kemi detajuar më poshtë me vlerë dhe me përqindjen, që ato zënë në totalin e të ardhurave nga tarifave vendore. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi.

#### **A.5.1. Trendi i të Ardhurave Jotatimore**

**Ecuria e realizimit të të ardhurave jotatimore paraqitet në tabelën e mëposhtme :**

Nr	Emertimi	Fakt		Plan 2022	P . B . A .		
		2020	2021		2023	2024	2025
1	Tarifave Vendore	118.412	163.951	198.666	214.678	227.992	235.113
2	Të ardhura nga Dhënia me Qera	7.798	8.829	8.385	7.185	7.185	6.943
3	Të Ardhura të Tjera	25.257	48.520	56.890	60.405	61.700	44.000
4	Të ardhura nga Instituc. treta	5.277	7.711	13.168	13.960	13.960	13.960
<b>Totali</b>		<b>156.744</b>	<b>229.010</b>	<b>277.109</b>	<b>296.228</b>	<b>310.837</b>	<b>300.016</b>

**Paraqitja grafike e të Ardhurave Jo Tatimore dhe Planifikimi për PBA 2023-2025**



Për vitin e kaluar buxhetor 2021, patëm një mosrealizim të ndjeshëm të planit të të ardhurave jotatimore, duke filluar nga zëri, që ka peshën më të madhe specifike, ku futen zërat e të Ardhurave nga



Tarifat Vendore, e cila është realizuar në masën e 163.951 mijë lekë nga 181.961 mijë lekë të planifikuara ose 90.1% e planit, më pas vijnë zërat e tjerë të të ardhurave jotatimore nga zëri të Ardhura të Tjera si ato nga kontributet / sponsorizimet, Debitorët nga Institucionet, nga Gjjobat, etj, të cilat nga 57.116 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën e 48.250 mijë lekë ose 84.9% e planit.

Një përqindje të lartë zënë edhe zërat e të ardhurave nga Institucionet e treta vartëse, si kopështet e çerdhet, të cilat nga 14.834 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën e 7.711 mijë lekë ose 52% e planit. Ndërsa me tregues pozitiv paraqiten të ardhurat e realizuara nga dhënia me qera e pronës, ku nga 8.030 mijë lekë të planifikuara janë realizuar të ardhura në masën e 8.827 mijë lekë ose 797 mijë lekë më shumë se plani ose rreth 10% më shumë se plani.

Pjesë përbërëse e të ardhurave jotatimore janë edhe të ardhurat nga Institucionet Vartëse si ato të planifikuara për mbulimin e shpenzimeve për Akomodimin e Fëmijëve në Kopështet dhe Çerdhe, të cilat janë realizuar për Kopështet në masën e 6.061 mijë lekë nga 11.954 mijë lekë të planifikuara ose 50.7% e planit dhe për Çerdhet në masën e 1.436 mijë lekë nga 2.880 mijë lekë të planifikuara ose 49.8 % e planit.

Një analizë më të hollësishme ne jemi përqëndruar në zërat e të ardhurave nga Tarifat e Shërbimeve Publike dhe ato Administrative, ku peshën më të madhe e zë Tarifa e Shërbimeve Publike si pastrim, ndriçim, gjelbërim, dekor dhe mirëmbajtje e varrezave publike, të cilat në paketën e vjetër fiskale janë fatuar në një zë të vetëm.

Për vitin 2022, të ardhurat e planifikuara sipas zërave, që analizuam më lart, janë parashikuar duke u bazuar në treguesit e realizimit të një viti më parë, në të dhënat kryesore, që ne si Bashki kemi për kategoritë e taksapaguesve Biznes dhe Familjarë për çdo zë tarife sipas shërbimeve të ofruara nga Drejtoritë përkatëse. Zëri kryesor i të ardhurave jotatimore, brenda zërit të Tarifave Vendore, është zëri i Tarifave të Shërbimeve Publike, parashikimi i të cilave për vitin 2022 është në total, në vlerën e 101.072 mijë lekë ose 51% e totalit të të ardhurave nga Tarifat Vendore.


Në këto shifra jemi bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për numrin e biznesve, sipas llojeve të aktivitetit, që ato ushtrojnë, numrin e Institucioneve Shtetërore me të dhënat përkatëse për faturim, numrin e familjarëve, që përfitojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nga Agjenti Tatimor Sh.A.U.K. Lezhë dhe numrin e familjarëve, që janë taksapagues, por që nuk e përfitojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nga Sh.A.U.K. Lezhë dhe faturohen nga specialistët përkatës në Njësitë Administrative ku ato marrin shërbimet publike.

#### **A.6. Të Ardhurat nga Tarifat Vendore**

Në zërat e të ardhurave nga tarifat vendore futen Tarifat e Shërbimeve Publike, të cilat në paketën e re fiskale për vitin 2022 u detajuan sipas zërave të shërbimeve, në Tarifën e Pastrimit, Tarifën e Gjelbërimit, Tarifën e Ndriçimit, Tarifën e Dekorit dhe Tarifën e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike. Më pas vijnë zërat e tjerë si Tarifa e Parkimit të Automjeteve, Tarifa për Dhënien e Liçencave dhe Certifikatave të Transportit, Tarifat për Zënie të Hapësirave Publike, Tarifat e Shërbimeve Urbanistike, Tarifat për Paisje me Liçencë Tregëtimi Lëndë Djegëse, Tarifat e Shërbimeve të Mjeteve Kundra Zjarrit, Tarifa për Shfrytëzimin e ambjenteve të Institucioneve Vartëse, Tarifa për përdorimin e Lëndëve Drusore, etj.

Nr	Emertimi	Fakt		Plan	P. B. A.		
		2020	2021	2022	2023	2024	2025
1	Tarifat e Shërbimeve Publike	70.433	98.372	101.072	106.072	111.065	199.293
2	Tarifa per Zënie te Hap. Publike	35.359	42.066	70.000	80.000	87.500	89.000
3	Tarifa e Parkimit te Automjeteve	4.774	7.891	7.245	7.400	7.700	7.850
4	Tarifa e Liç. Transp. Udhet. & Mall.	1.292	898	1.480	1.500	1.550	1.560
5	Tarifa Paisje Liç. Shitje Lende Dj.	800	2.400	4.000	4.000	4.000	4.000
6	Tarifa te Sherb. Drejt. PLT & Zh. Urban	4.279	9.742	11.000	12.000	12.500	13.000
7	Tarifa te Sherbimit Veteriner	338	630	0	0	0	0
8	Tarifa per Sherbime te PMNZSH	752	1.070	1.325	1.360	1.375	1.380
9	Tarifa e Lendeve Drusore	105	57	509	529	549	600
10	Tarifa e Sherb. te Ujitjes dhe Kullimit	6	0	0	0	0	0
11	Tarifa Shfryt. Ambjent. Instit. Vartese	274	825	2.035	1.408	1.753	1.693
<b>Totali</b>		<b>118.412</b>	<b>163.951</b>	<b>198.666</b>	<b>214.678</b>	<b>227.992</b>	<b>235.113</b>

Paraqitja grafike e të Ardhurave nga tarifate Vendore dhe Planifikimi për PBA 2023-2025



Për vitin e kaluar buxhetor 2021, patëm një mosrealizim të planit të të ardhurave nga Tarifate Vendore, për disa nga zërat, që zënë një peshë jo të madhe në totalin e të ardhurave nga tarifate vendore, si Tarifa për Zënie të Hapësirave Publike, e cila nga 60.000 mijë lekë të planifikuara është realizuar në masën e 42.066 mijë lekë ose 70.1% e planit, Tarifa e Liçencimit të Transportit të Udhëtarëve dhe Mallrave, e cila nga 1.319 mijë lekë të planifikuara është realizuar në masën e 898 mijë lekë ose 68.1% e planit, Tarifa të Shërbimit Veteriner, e cila nga 782 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 630 mijë lekë ose 80.5% e planit, Tarifa për Shërbime të Zjarrfikësve, e cila nga 1.860 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 1.070 mijë lekë ose 57.6% e planit, Tarifa e Lëndëve Drusore, e cila nga 489 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 57 mijë lekë ose 11.7% e planit dhe Tarifate e Shfrytëzimit të Ambjenteve të Institucioneve Vartëse, e cila nga 1.588 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 825 mijë lekë ose 52% e planit.

Nga të gjithë zërat e tarifave vendore, treguesit më pozitiv janë për Tarifën e Parkimit të Automjeteve, e cila nga 4.500 mijë lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 7.891 mijë lekë ose 75.4% mbi planin, më pas vjen Tarifa për Paisje me Liçencë të Shitjes së Lëndëve Djegëse, e cila nga 2.000 mijë

lekë të planifikuara, është realizuar në masën e 2.400 mijë lekë ose 20% mbi planin, më pas me tregues mjaft pozitiv në një planifikim real është tarifa e shërbimeve publike, e cila nga 99.352 mijë lekë të planifikuara është realizuar në masën e 98.372 mijë lekë ose 99% e planit, ndërsa në fund fare vjen Tarifa e Shërbimeve të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, e cila nga 10.000 mijë lekë të planifikuara është realizuar në masën e 9.742 mijë lekë ose 97.4% e planit.


Për vitin buxhetor 2022, planifikimi i këtyre tarifave është bërë bazuar edhe në treguesit e një viti më parë, përjashto Tarifën e Shërbimeve Publike, e cila si bazë ka treguesit e të dhënave për numrin dhe llojet aktiviteteve për kategorinë Biznes, Familjar dhe Institucione, të cilat i nënshtrohen pagesës së këtyre tarifave si rezultat i përfitimit të shërbimeve publike të ofruara nga Bashkia.

Krahasuar me realizimin e një viti më parë Tarifa e Shërbimeve Publike parashikohet me një rritje e cila kap vlerën e 101.072 mijë lekë ose 2.7% më shumë se realizimi i një viti më parë, ndërsa trendi për vitet e ardhshme 2023-2025 parashikohet të kapë vlerat në rritje deri në 5% vit pas viti.


Ndërsa në total Tarifat vendore kapin vlerën e 198.666 mijë lekë ose 34.175 mijë lekë më shumë se realizimi i një viti më parë, me një rritje prej 21%. Në ndryshim nga realizimi i një viti më parë, për vitin buxhetor 2022 janë planifikuar të ardhura nga zëri i tarifave vendore pothuajse në të njëjtin nivel më vitin e kaluar. Kjo bazuar kryesisht në gjithë përfshirjen e çdo taksapaguesi në faturimin dhe arkëtimin e çdo zëri të tarifës së shërbimeve të ofruara nga Bashkia, duke filluar që nga punonjësit e Bashkisë e deri tek qytetari më i thjeshtë, duke përjashtuar ato, që përfitojnë lehtësirat fiskale konform legjislacionit në fuqi.

Për vitin korent buxhetor 2022, në totalin e të ardhurave nga tarifatat vendore, peshën kryesore e zë Tarifa e Shërbimeve Publike, e cila është planifikuar në masën e 101.072 mijë lekë ose rreth 50.9% e totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore.


Zgjerimi i bazës së tatueshme dhe vjelja e detyrimeve të prapambetura për këtë zë tarife janë objektivat kryesore të DTTV. Tregues bazë në planifikimin e të ardhurave nga këto zëra janë të dhënat e marra nga sistemi elektronik i të dhënave mbi numrin dhe llojet e kategorive të taksapaguesve Biznes si dhe të dhënat e kategorisë së taksapaguesve Familjarë dhe Institucione.




Ecuria dhe planifikimi i treguesve të Tarifave të Shërbimeve Publike për taksapaguesit “Familjar”




Ecuria dhe planifikimi i treguesve të Tarifave të Shërbimeve Publike për taksapaguesit “Biznes”




Në vendin e dytë, renditet Tarifa e Zënies së Hapësirave Publike, e cila është planifikuar në vlerën e 70.000 mijë lekë ose 35.2 % e totalit të të ardhurave nga zëri i tarifave vendore.




Më pas renditen Tarifa e Shërbimeve Administrative të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, e cila është planifikuar në vlerën e 11.000 mijë lekë ose 5.5 % e totalit të të ardhurave nga zëri i tarifave vendore,



pastaj vjen Tarifa e Parkimit të Automjeteve, e cila është planifikuar në vlerën e 7.245 mijë lekë ose 3.6% e totalit të të ardhurave nga zëri i tarifave vendore,




ndërsa pjesën tjetër e mbulojnë tarifat e Liçencimit në Transportin e Mallrave dhe Udhëtarëve dhe për Shitjen e Lëndëve Djegëse, Tarifat e e Lëndës Drusore, e Shërbimeve të PMNZSH dhe ato për Shfrytëzim të Ambjenteve të Institucioneve Vartëse, të cilat kapin vlerën e 9.349 mijë lekë ose 5% të totalit të të ardhurave nga zëri i tarifave vendore.



#### A.7. Të Ardhurat nga Qeradhënia e Pronës

Këtu hyjnë të ardhurat e siguruar nga dhënia me qera e pronës publike, e cila është planifikuar duke u bazuar në kontratat egzistuese, të cilat kapin vlerën e 8.385 mijë lekë ose 3 % e të ardhurave jostatimore.




#### A.8. Të Ardhura të Tjera

Për vitin e shkuar buxhetor 2021, peshën kryesore e kanë mbuluar të ardhurat nga Kontributet e Sponsorizimet, të cilat janë realizuar në vlerën e 37.913 mijë lekë ose rreth 78.1% e totalit të të ardhurave nga zëri të Ardhura të Tjera, ndërsa pjesën tjetër e mbulojnë zërat e të ardhurave nga Gjobat në vlerën e 10.478 mijë lekë nga 5.970 mijë lekë të planifikuara me thujse dyfishim të realizimit të planit, që kapin vlerën e 21.6 % të totalit të të ardhurave nga zëri të Ardhura të Tjera, si dhe të Ardhura

të Tjera, të gjitha në shumën e 129 mijë lekë ose 0.3% e totalit të të ardhurave nga zëri të Ardhura të Tjera.


Paraqitja grafike e të Ardhurave të Tjera dhe Planifikimi për PBA 2023-2025



Për vitin korent buxhetor 2022, burimi kryesor i të ardhurave për zërin e Të Ardhurave të Tjera Jotatimore është zëri Kontribute e Sponsorizime, që është parashikuar me rritje falë performancës së mirë që ka pasur gjatë vitit të shkuar dhe do ketë në vijim Bashkia Lezhë, duke u planifikuar në vlerën e 51.000 mijë lekë ose 89.6% e e totalit të të ardhurave nga zëri të Ardhura të Tjera dhe 18.4% e totalit të të ardhurave jotatimore. Me rritje është parashikuar edhe zëri i të ardhurave nga vendosja e penaltiteteve ndaj çdo kategorie taksapaguesish, që kap vlerën e 5.770 mijë lekë ose 10.1% e totalit të të ardhurave nga zëri Të Ardhura të Tjera.

#### A.9. Të Ardhurat nga Institucionet Vartëse

Këtu futen të ardhurat e siguruar nga mbulimi i shpenzimeve për ofrimin e shërbimit për akomodimin e fëmijëve në qerdhe e kopështe.



Këtu futen të ardhurat e siguruar nga mbulimi i shpenzimeve për ofrimin e shërbimit për akomodimin e fëmijëve në qerdhe e kopështe. Vlerat e planifikuara janë bërë duke u bazuar në shpenzimet bazë të cilat është detyrim ligjor për ruajtjen e standarteve të ofrimit të këtij shërbimi ndaj asaj kategorie përfituesish. Vlerat e planifikuara janë në masën e 3.168 mijë lekë dhe 10.000 mijë leke ose 24.1 % dhe 75.9 % e totalit të të Ardhurave të Tjera nga Institucionet Vartëse, respektivisht për akomodimin e fëmijëve në qerdhe dhe në kopështe. Brenda këtyre vlerave janë të përfshira edhe detyrimet e prapambetura të palikujduara për efekte të pandemisë, që kaloi vendi ynë, nga prindërit e asaj kategorie përfituesish të shërbimeve.


## B. Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

### B.1 Taksapaguesit familjarë

Shpërndarja e treguesve të numrit të familjeve, që janë banorë sipas njësisive Administrative dhe e atyre familjeve që janë përfitues të lehtësirave fiskale, paraqitet si më poshtë:


Nr	Emërtimi	Nr.Fam	Kategoritë që përfitojnë lehtësira fiskale							Familje që tarifohen
			Me Nd.Ek	Prapl / tetra pl	Te verber	Me aftësi të kufizuara	Invalid Punc	Pensionistë	Viktima të dhunës	
A	Zona A	13.720	158	82	99	552	919	10	51	11.886
1	Nja.Adm.Lezhë	9.682	117	57	78	433	703	10	14	8.270
2	Nj.Adm.Shëngjin	4.038	41	25	21	119	216	0	0	3.616
B	Zona B	9.693	507	69	90	562	622	38	0	7.764
3	Nja.Adm.Shënkoll	4.709	183	36	38	280	325	18	15	3.814
4	Nj.Adm.Zejmen	2.665	130	19	32	152	150	15	17	2.150
5	Nja.Adm.Kolsh	2.319	194	14	20	130	147	5	9	1.800
C	Zona C	9.393	403	48	67	412	540	24	23	7.876
6	Nja.Adm.Balldre	2.906	106	19	14	136	193	10	10	2.418
7	Nj.Adm.Bllinisht	1.547	69	4	20	64	89	3	6	1.292
8	Nja.Adm.Dajç	2.107	69	12	10	71	118	8	2	1.817
9	Nj.Adm.Kallmet	1.976	66	10	14	99	100	3	3	1.681
10	Nj.Adm.Ungrej	857	93	3	9	42	40	0	2	668
	Familje gjithsej	32.806	1.968	199	256	1.526	2.081	72	78	27.526

Në total numri i familjeve, që janë banorë të Bashkisë Lezhë është me një numër prej 32.806 familje dhe kanë shpërndarjen sipas Njësisive Administrative me kapacitetet si më poshtë:



Në total numri i familjeve, që parashikohen të përshihen në listën e taksapaguesve familjarë është 27.526 familje, të cilat kanë një shpërndarje sipas njësisive administrative përkatëse:

Numri i Taksapaguesve (Kategoria Familjare) me taksa / tarifa të plota



- Nja.Adm.Lezhë
- Nj.Adm.Shëngjin
- Nja.Adm.Shënkoll
- Nj.Adm.Zefmen
- Nja.Adm.Kolsh
- Nja.Adm.Balldre
- Nj.Adm.Blinisht
- Nja.Adm.Dajç
- Nj.Adm.Kallmet
- Nj.Adm.Ungrej
- Familje gjithsej

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësira fiskale për familjet me probleme sociale, si dhe për familjet, që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj.


Kapacitetet fiskale të taksapaguesve në numër.

Taksapaguesit familjarë në numër dhe në përqindje, sipas zonave dhe paraqitja grafike e tyre sipas ndarjes zonale, paraqitet si më poshtë :

Nr	Bashkia Lezhë / Zonat	Numri i Taksapaguesve (Kategoria Familjare) me taksa / tarifa të plota	Numri i Taksapaguesve (Kategoria Familjare) që përfitojnë lehtësi fiskale	Numri i Familjeve Gjithsej
1	Zona A	11.896	1.824	13.720
2	Zona B	7.764	1.929	9.693
3	Zona C	7.876	1.517	9.393
	Gjithsej	27.536	5.270	32.806

Grafiku me të dhënat e taksapaguesve të Familjarë, të cilët paguajnë taksat dhe tarifave vendore :


Numri i Taksapaguesve (Kategoria Familjare) me taksa / tarifa të plota




- Zona A
- Zona B
- Zona C



Grafiku me të dhënat e taksapaguesve të Familjarë, të cilët përfitojnë lehtësira fiskale, në pagesën e taksave dhe tarifave vendore, të ndara sipas zonave.



Grafiku me të dhënat e taksapaguesve të Familjarë, të cilët përfitojnë lehtësira fiskale, në pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në raport me numrin e përgjithshëm të kategorisë së taksapaguesve familjarë.



Nga 33.088 familje, që ka Bashkia Lezhë, përfitues të lehtësirave fiskale konform legjislacionit në fuqi janë 3.101 familje, ose rreth 10%, të cilët nuk përfshihen në numrin e taksapaguesve familjarë. Ndërsa kontribues në pagimin e taksave si taksapagues familjarë janë rreth 90% e numrit të përgjithshëm të familjeve të Bashkisë Lezhë.

Kontributin kryesor në arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, për kategorinë e taksapaguesve familjarë, e ka Agjenti Tatimor, Sh.A.U.K. Lezhë, i cili arkëton sipas planit, që ne kemi për vitin korent 2022 shumën prej 51.902 mijë lekë nga 740.000 mijë lekë të planifikuara për totalin e të Ardhurave ose 7%. Kurse të ndara sipas zërave, vlerat janë 25.262 mijë lekë për zërin e taksës mbi ndërtesat për kategorinë familjar dhe 26.640 mijë lekë të planifikuara për zërin e tarifës së shërbimeve publike, për kategorinë Familjarë.


## B.2. Takspaguesit Biznes

Mbështetur në të dhënat e disponueshme sipas çdo dosje të dokumentacionit fizik të deklaruar nga takspaguesit dhe sipas të dhënave të hedhura në sistemin tatimor nga Specialistët përkatës të D.T.T.V., rezultojnë se numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara në Bashkinë Lezhë sot është 4.328 biznese, të ndara respektivisht në 2.963 biznes i vogël ose 68.5% e numrit të përgjithshëm të bizneseve, 418 janë tregtar ambulant të cilët zënë një peshë specifike prej rreth 9.7% të numrit të përgjithshëm të bizneseve, ndërsa diferenca prej 947 subjekte ose 21.9% janë biznes i madh.

Më poshtë paraqitja grafike e numrit të përgjithshëm të bizneseve :

Nr	Kategoritë e Takspaguesve	Numri i Takspaguesve (kategoria Biznes)
1	Biznes i Madh	947
2	Biznes i Vogël	3.381
<b>Gjithsej</b>		<b>4.328</b>


Paraqitja grafike e peshës që zënë takspaguesit e kategorisë Biznes



Ndarja e kategorisë së takspaguesve biznes sipas Zonave, që ato përfitojnë shërbimet publike


Nr	Emërtimi	Zona A	Zona B	Zona C
1	Biznes i Madh	742	166	39
2	Biznes i Vogël	2.850	407	124
<b>Gjithsej</b>		<b>3.592</b>	<b>573</b>	<b>163</b>

Paraqitja grafikepeshës që zënë sipas zonave ku ofrohet shërbimi publik




Pëllogaritja e të ardhurave për çdo zë takse e tarife për kategorinë e taksapaguesve biznes, bëhet duke ditur saktë llojin e biznesit, pra në cilën njësi hyn, nivelin e xhiros vjetore, që ai realizon sepse tarfa e shërbimeve publike faturohet sipas nivelit të xhiros dhe vendndodhja ku ushtron aktivitetin, pasi ka diferencime në zonat e qytetit. Pas evidentimit që ne bëmë, shpërndarja e tyre paraqitet si më poshtë :

Nr	Lloji i Aktivitetit	Biznes i Vogël			Biznes i Madh			Total
		Zona A	Zona B	Zona C	Zona A	Zona B	Zona C	
1	Njësi Tregtare	1.134	240	76	328	77	24	1.879
2	Njësi Prodhimi	180	25	16	51	52	8	232
3	Njësi Ndërtimi	147	27	2	35	4	2	217
4	Njësi Shërbimi	896	99	13	311	31	5	1.355
5	Ambulant	418	0	0	0	0	0	418
6	Njësi Prof. të Lira	76	5	0	7	0	0	88
7	Njësi Trans..Tokësor	59	11	17	1	1	0	89
8	Njësi Peshkimi Detar	40	0	0	9	1	0	50
<b>Gjithsej</b>		<b>2.850</b>	<b>407</b>	<b>124</b>	<b>742</b>	<b>166</b>	<b>39</b>	<b>4.328</b>




Më poshtë shpërndarja e bizneseve kategoria Biznes i Vogël, sipas Zonave

Nr	Lloji i Aktivitetit	Biznes i Vogël		
		Zona A	Zona B	Zona C
1	Njësi Tregtare	1.134	240	76
2	Njësi Prodhimi	180	25	16
3	Njësi Ndërtimi	147	27	2
4	Njësi Shërbimi	896	99	13
5	Ambulant	418	0	0
6	Njësi Profesione të Lira	76	5	0
7	Njësi Transporti tokësor	59	11	17
8	Njësi Peshkimi Detar	40	0	0
<b>Gjithsej</b>		<b>2.850</b>	<b>407</b>	<b>124</b>



Më poshtë shpërndarja e bizneseve kategoria Biznes i Madh, sipas Zonave

Nr	Lloji i Aktivitetit	Biznes i Madh		
		Zona A	Zona B	Zona C
1	Njësi Tregtare	328	77	24
2	Njësi Prodhimi	51	52	8
3	Njësi Ndërtimi	35	4	2
4	Njësi Shërbimi	311	31	5
5	Ambulant	0	0	0
6	Njësi Profesione të Lira	7	0	0
7	Njësi Transporti tokësor	1	1	0
8	Njësi Peshkimi Detar	9	1	0
<b>Gjithsej</b>		<b>742</b>	<b>166</b>	<b>39</b>



Numrin më të madh të taksapaguesve të kategorisë Biznes e zënë ato subjekte, që ushtrojnë aktivitetin si Njësi Tregtare, të cilët kapin shifrat e 1.879 subjekte ose 43.4% e totalit të Bizneseve, nga të cilat 1.450 janë Biznes i vogël dhe diferenca 429 janë Biznes i Madh ose respektivisht 77.2% dhe 22.8% e totalit të Njësive Tregtare. Më pas në vendine dytë renditen subjektet, që ushtrojnë aktivitet si Njësi Shërbimi, të cilët kapin shifrën e 1.355 subjekte ose 31.3% e totalit të Bizneseve, nga të cilat 1.008 janë Biznes i vogël dhe diferenca 347 janë Biznes i Madh ose respektivisht ose 74.4% dhe 25.6% e totalit të Njësive të Shërbimit.


### **B.3. Taksapagues Institucione**

Numri i përgjithshëm i Institucioneve, të cilat ushtrojnë detyrat dhe funksionet e veta në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë, që janë përfitues të shërbimeve publike të ofruara nga Bashkia është 20. Të gjithë Institucionet Shtetërore, janë të përjashtuar nga pagesa e taksës mbi ndërtesat. Detyrimi i tyre është vetëm për tarifën e shërbimeve publike, i cili llogaritet duke marrë për bazë sipërfaqen në metër katror të ndërtesës ku Institucioni ushtron aktivitetin. Më poshtë janë të renditura Institucionet Shtetërore, me emërtesat dhe të dhënat për sipërfaqen më, metër ktaror dhe detyrimin përkatës për tarifën e shërbimeve publike. kundrejt përfitimit të këtij shërbimi të ofruar nga Bashkia Lezhë.

Më poshtë, paraqitja grafike e të dhënave për Institucionet Shtetërore


Nr	Subjektet / Institucione Shtetërore	Sip. në m <sup>2</sup>
1	DREJTORIA RAJONALE SIGURIMEVE SHOQERORE	543
2	SHERBIMI INFORMATIV SHTETEROR	120
3	ZYRA E RREGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME	800
4	GJYKATA E RRETHIT GHYQESOR LEZHE	341
5	INSPEKTORIATI SHTETEROR I PUNES	100
6	PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR LEZHE	932
7	AGJENSIA E SIGURIMEVE SHOQERORE	0
8	KËSHILLI I QARKUT LEZHË	0
9	DREJTORIA RAJONALE E TATIM TAKSAVE	780
10	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT	500
11	DREJTORIA VENDORE E POLICISE	2229
12	ALUIZNI QARKU LEZHË	0
13	DREJTORIA RAJONALE DOGANORE LEZHË	500
14	BORDI KULLIMIT LEZHË	366
15	DREJTORIA RAJONALE E SHENDETIT PUBLIK LEZHE	678
16	DEGA E THESARIT LEZHË	173
17	ZYRA RAJONALE E STATISTIKAVE LEZHE	23
18	DREJTORIA R. FONDIT TE SIG. TE DETYRUESHEM TE KUJD. SHEND.	254
19	DREJTORIA E PERGJITHSHEM E ARKIVAVE( ARKIVA LEZHE)	256
20	DREJTORIA BUJQESISE LEZHE	281
	<b>Gjithsej</b>	<b>8876</b>






Ndërsa në vlerë monetare efekti ekonomik nga mosfaturimi i asaj kategorie përfituesish, që cituam më lart, kap vlerën e 10.216 mijë lekë.

Nr	Zonat	Vlera e efektit ekonomik (000/leke)
1	A	5.202
2	B	2.894
3	C	1.820
Gjithsej		10.216




#### **D. Fluksi monetar i të Ardhurave të Veta.**


Falë fokusimit për zgjerimin evazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj., të ardhurat parashikohet të ruajnë një nivel konstant të arkëtimit, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe kapacitetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të Bashkisë. Ecuria e fluksit monetar nga Taksat Vendore :



Ecuria e fluksit monetar nga Tarifatat Vendore



Ecuria e fluksit monetar nga të ardhurat në total për vitin kalendarik 2022



Parashikimi është bërë duke marrë për bazë afatet ligjore të shlyerjes së detyrimeve nga çdo kategori taksapaguesi. Nivelet më të lartatë arkëtimit janë parashikuar në muajt Maj-Qershor, periudhë e përcaktuar për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi për Taksën mbi Pasurinë dhe këstin e parë për Tarifën e Shërbimeve Publike. Ndërkohë parashikohet një ruajtje në pothuaj të njëjtin nivel gjatë muajve në vijim dhe rënie nga fundi i vitit si efekt i njoftimeve, pagesave në kohë nga taksapaguesit si dhe marrjes së masave shtrënguese ndaj debitorëve.



### E.Analiza e riskut dhe masat për përballimin e tyre.

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është, që risku të menaxhohet në mënyrë efektive. Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillen njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet, që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi. Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive nxitëse e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë.

Tabela e Analizës së Riskut

Nr	Përshkrimi i Riskut	Risku para kontrollit (ulët / mesëm / lartë)	Kontrollet egzistuese	Risqet pas kontrolleve egzistuese	Nevoja për kontrolle të mëtejshme (po / jo)	Veprime për të adresuar boshllëqet	Zonëvesi i Riskut	Ndriçimet e riskut (përkrahësit / përmirësohet / i pandryshuar
1	Mungesa e informacionit në terren.	Ulët	Monitorim në terren nga inspektori i zonës	Ulët	po	Përgatitje e planeve të punës për evidentim	S.R.V. K. T	Përmirësohet
2	Mungesa e informacionit nga ASHK	mesëm	Kërkese me shkrim për informacion	Mesëm	po	Krijë e bashkëpunimit shkresor me ASHK	ASHK / ZRPP	Përmirësohet
3	Mungesa e informacionit nga QKR	Ulët	Kërkese me shkrim për informacion	Ulët	po	Krijë e bashkëpunimit shkresor me QKR	QKR	Përmirësohet
4	Dokumentacion i plotë arkivor	ulët	Pasurimi me dokumentacion pronësie	ulët	po	Pasurimi gjatë kontrolleve dhe dhënies së stërimit ndaj taksapaguesit	S.R.V. K. T.	Përmirësohet
5	Mungesa e informacionit nga Nj.A.	Mesëm	Monitorim dhe kontroll në terren nga S.R. K. V. T në bashkëpunim me Nj.A.	Ulët	po	Ngritja e grupeve të punës nga S.K. V. T. për evidentim të takapaguesve	S.R.V. K. T	Përmirësohet
6	Evidentim të Debitorëve për taksat dhe tarifat e vjetra nga Agjenti tatimor	Mesëm	Krijë e cilësish së informacionit të sjellë nga ana e agj. tatimor	Mesëm	po	Mbështetje dhe bashkëpunim nga Agjenti Tatimor Sh.A.U.K.Lezhë	Agjenti Tatimor Sh.A.U.K.Le	Përmirësohet
7	Dokumentacion ligjor bazues për taksat	ulët	Pasurimi me dokumentacion pronësie	ulët	po	Pasurimi gjatë marrjes së info nga taksapaguesi dhe kontrollit në terren	Z.I.N S.R.V. K. T.	Përmirësohet
8	Ndiesja e masave shtrënguese	mesëm	Njoftime me postë dhe	mesëm	po	Përgatitja e planit të veprimit	S.M.M.B	Pa ndryshuar
9	Rakordim i shpejtë i pagesave	Lartë	Kërkese me shkrim D.F.B.	ulët	jo	Plan veprimi për rakordim të ardhura me D.F.B	S.R.V. K. T	Pandryshuar
10	Përmirësim i marrëdhënies mes taksapaguesve dhe administratës tatimore	Mesëm	Fushatë sensibilizuese, media, Website bashkia etj.	ulët	jo	Trajtim në kohë reale të ankesave dhe kërkesave	S.R.V. K. T S.M.M.B Z.I.N.	Përmirësohet
11	Realizimi i planit të të ardhurave nga taksat	Mesëm	Analiza mujore sipas zërave dhe sektorëve	Mesëm	po	Shqyrtimi i zërave sipas securitë së vijës dhe arkëtimit të tyre	S.R.V. K. T S.M.M.B Z.I.N.	Përmirësohet
12	Realizimi i planit të të ardhurave nga Agjenti Tatimor	Lartë	Analiza mujore	mesëm	jo	Analizë për punën e kryer nga agjenti tatimor	S.R.V. K. T Z.I.N.	Përmirësohet

13	Instalimi dhe implementimi i programit dhe moduleve shpresë	Lartë	Bashkëpunim me kompaninë përkatëse	mesëm	jo	Evidentimi i mangësive dhe problematikave të data grata punës	S.R.V. K. T Z.I.N.	Pandryshuar
14	Dhënie informacioni për taksapaguesit nga Adm. Tatimore	Mesëm	Oftimi i shërbimit pranë Z.I.N.	mesëm	jo	Evidentimi i kohës që harxhon taksapaguesi në sportelet e Z.I.N.	S.R.V. K. T	Pandryshuar
15	Shërbime dhe veprimet online për taksapaguesin	Lartë	Bashkëpunim me programuesit	ulët	po	Shqyrtimi i nevojës së taksapaguesit	S.R.V. K. T dhe Spec. IT	Pandryshuar
16	Përmirësim me standardet e reja ligjore	Mesëm	Shqyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve ligjore	ulët	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	D.T.T.V	Pandryshuar
17	Njohje me eksperience të ngjishme dhe trajnime profesionale	Mesëm	Trajnime dhe diskutime mbi to	ulët	po	Diskutime dhe konstatime	D.T.T.V	Pandryshuar